

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenet 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **00220-25-4984-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me material për Hemodializë nga LE për nevojat e SHSKUK-së – Lot 1, 3 dhe 6**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Medi Health L.L.C. _____

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Preoc, Magj. Ferizaj - Prishtinë, p.nr _____

(Adresa)

Graçanicë _____

(Vendi)

(Kodi postar)

+38345746220 _____

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Saim Krasniqi _____

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

medihealthllc1@gmail.com _____

(Adresa elektronike)

24.10.2025 _____

(Data e parashtrimit të kërkesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefoni)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit te ankesses)

(Niveli i detyrimit dhe vleres)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

(Shëno një përdhoro te shkakto lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Konkurs" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie te Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit te Projektimit" apo "Njoftim për ankim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kritere për dhënien te kontratës):

- Njoftimi për kontrate 03.06.2025
- Hapja e ofertave 28.08.2025
- Njoftimi mbi vendim të AK-së 08.10.2024
- Kërkesë për t'u shqyrtim - 13.10.2025
- Vendimi i AK- SHSKUK Refuzimi i kërkesës 16.10.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë ne procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht eciminë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo

- Hapja e ofertave 28.08.2025

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e menjëhershme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me rezultatet e eliminimit tuaj?

Po ☐

Jo

Më datë 13.10.2025, kompania jonë ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të vendimit të AK-SHSHKUK-së, duke kundërshtuar propozimin për dhënien e kontratës në lotet e cekura. Në këtë kërkesë u parashtruan prova dhe fakte që dëshmojnë për ndërfytyrë fizike në dokumente

zyrtarë, siç është katalogu. Sidoqoftë, AK - SHSKUK, me vendimin e saj të datës 16.10.2025, e refuzoi kërkesën si të pajtuar dhe ta në fuqi vendimin, i cili vlerësohet si i kundërligjshëm në të gjitha aspektet, ka me këto veprime tani me janë konsumuar edhe shkelje të reja nga neni 108/A i LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitet ose dispozitat e LPP-së që supozohen të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimeve, dhe nëse aplikohen gjërë në përmbajtjen e këtij skemati të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultate të Konkursit të Projektimeve apo Njoftimit për Analizë.

Ligji për prokurim publik, nr 04/L-042 i amendamentuar me ligjet tjera

- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
- Neni 25 Trajtimi : Zyrtareve të Prokurimit
- Neni 28 Specifikimet teknike
- Neni 51 Njoftimi i Kriterëve të Përzgjedhjes
- Neni 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës
- Neni 61 Tenderët Jo-normalisht të Ulët
- Neni 59 Vlerësimi, kalasimi dhe ekzaminimi i ofertave
- Neni 70 Standardet për sigurimin e Cilësisë
- Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve
- Neni 130 – Ndikimi i paligjshëm

Rregullorja me nr. 001/2022, për Prokurim Publik

- Neni 25 Kriteret e përzgjedhjes
- Neni 97 Shkeljet e rënda

Rregullorja për enime jo-normalisht të ulëta

*** Siqis, Neni 118 të LPP, OSHP-jo du të kthejë tarifën tuaj nëse ankera aprovatet si e bazuar. OSHP jo mund të kërkojë një gjohë rritje të 5.000 Euro në rastet kur OSHP-jo konstaton që të gjitha apo cilito nga pretendimet e përpeshuara në ankera kanë qenë të vërtetshme me mbështetje.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani çdoherat faktike që përfaqësojnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP së Ofronit deklarativ të qartë dhe të denjuar për faktet dhe argumentet të cilin mbështetja secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar,

Autoriteti Kontraktues – Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës, me datën 06.10.2025, ka publikuar formularin 958 - Njoftimin mbi vendimin e AK-se, për këtë procedurë të prokurimit dhe ne, lotet, 1, 3, dhe 6, ka rekomanduar kundërligjshëm kompani të pa përgjegjshme në aspekt administrativ, teknik dhe financiar, si rrjedhojë e kësaj kompani "Medi Healer" LLC, bazuar në afatime pamapare me neni 108/A i LPP-se, me datën 15.10.2025, ka parashtruar kërkesë për ri shqyrtim, ndërsa AK - SHSKUK, me vendimin e saj të datës 16.10.2025, refuzoi kërkesën tonë duke e mohuar gjendjen faktike të ofertës së rekomanduar për dhënie në këto lotë duke mohuar dhe duke mos e trajtuar fare qeshtin e ekspertizës grafike, komunikimin me prodhuesin "Saxia" për mos-poseidimin e

CE Certifikatës për produktin 650g , si dhe shkelja e rregullave për tenderët jo-normalisht të ulët, pretendime këto të argumentuara me prova konkrete por të cilat nuk janë marrë parasysh apo janë injoruar në mënyrë jo-ligjore nga AK- SHSKUK, prandaj bazuar në nenin 109, të LPP-se, paraqesim argumentet tona si më poshte:

KËRKESË HYRESE PËR OSHP

Për shkak të natyrës specifike teknike dhe forenzike të provave tona – posaçërisht falsifikimit të katalogut dhe rrezikut shëndetësor të pacientëve në Hemodializë që buron nga mungesa e CE Certifikatës për produktin 650 gr kërkojmë që OSHP, Paneli Shqyrtues dhe Zyrtaret Autorizues, të autorizojë ekspert të pavarur, të paanshëm dhe objektiv për të kryer shqyrtim dhe vlerësim profesional mbi:

1. **Vërtetimin Forenzik:** Konfirmimin e gjetjeve të Ekspertizës sonë Gjyqësore Tekninko-Grafike (Prova Nr. 10.1, datë 13.10.2025) lidhur me **ndërhyrjen fizike** - manipulimin e fontit dhe shtimin e të dhënave në katalogun e dorëzuar nga OE Meditech.
2. **Konfirmimin e Cilësisë/Sigurisë (CE):** Verifikimin zyrtar, përmes organeve kompetente, të vlefshmërisë së CE Certifikatës për specifikën e saktë të produktit 650gr Koncentrat Pluhur Bikarbonatesh.
3. **Përputhshmërinë Teknike (Lot 6):** Vlerësimin nëse katalogu i dorëzuar nga OE Meditech përmban dëshmitë e kërkuara në mënyrë dokumentare për parametrat thelbësorë - Diametri i dhomëzës venoze 18-22mm dhe Segmenti i pompës 8mm me gjatësi mbi 32cm, të cilat nuk figurojnë në katalogun e prezantuar.

Pretendimi ankimore 1:

Operatori Ekonomik i rekomanduar për dhenin e kontratës në lotet 1, 3 dhe 6 “Meditech”, ka ofetuar me katalog të falsifikuar. Në si OE ankues, kompani e pergejgjeshme dhe me interes juridik, në kërkesën për ri shqyrtim të datës 13.10.2025, kemi prezantuar prova konkrete, ndërhyrjen në katalog të prezantuar në ofertën e të njëjtes kompani sa i përket lotit 1, dhe për këtë qeshtë kemi autorizuar ekspertizë të pavarur grafike dhe si dëshmi e kemi prezantuar të njëjten ekspertizë në cilësi të proves, kemi prezantuar edhe katalogun e prodhuesit me të cilin është ofetuar “Sanxin” i cili është ende publik në web faqen e prodhuesit dhe pavaresisht këtyre provave AK – SHSKUK, me vendimin e datës 16.10.2025, mbi refuzimin e kërkesës tone përveq se refuzon si të pa bazuar kërkesën injoron provat, përkatësisht ekspertizën grafike, komunikimin me prodhuesin “Sanxin” për mos-posedimin e CE Certifikatës për produktin 650g , si dhe shkelja e rregullave për tenderët jo-normalisht të ulët, dhe mos ofrimin e qasjes në dokumentet e OE ve tjerë pjesëmarres “Medicom”, “MediLor” dhe “TrimMed etj”.

- Bazuar në dokumentet e prezantuara në oferte për Lotet 1, 3 dhe 6, ku OE “Meditech” është shpallur fituese, Autoritet Kontraktues, komisionin vlerësues i ofertave dhe zyrtarin përgjegjës të prokurimit i inkriminon dhe i bënë përgjegjës penalisht dhenia e kontratave në llotet e tilla pasi që ofertuesi Meditech, në emër të prodhuesit “Jiangxi Sanxin Medtec Co., Ltd”, për Lotin 1, ka paraqitur dëshmi të rrejshme, të manipuluar – falsifikuara, sa i përket specifikacioneve teknike dhe katalogun e prodhuesit.

AK – SHSKUK, në aneksin 1 të dosjes si kërkesë për lotin 1 kakerkuar: **“Koncentrat Pluhur i Bikarbonateve në qese 650 gr”, kompatibil me pajisjen ekzistuese 4008S”**

Ky konstatim është konfirmuar nga vete anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave gjegjësisht mostrave ku në raportin e vlerësimit të ofertave pershkrulet se katalogu i prezantuar në ofertën e OE "Meditech" për Lotin 1, ka ndërhyrje fizike dhe ka nënvizuar me "highlight" rreshtin për produktin SXG-F, SXG-F-B 650g, kompatibel me aparatet 4008S dhe 5008S dhe deklarojnë se i njëjti katalog në web faqen e prodhuesit nuk e ka këtë rresht as këtë doze.

Prove: Verejtja e pershkruar në raport të vlerësimit të ofertave e nëshkruar nga anëtarja e komisionit me datën 02.10.2025.

Verejtja përmblylloret në lidhje me vlerësimin e tenderëve të përgjegjësim:

Për Lot 1, sipas komisionit të vlerësimit të mostrës u verifikua se katalogu i prezantuar nga OE respektiv ka me highlight rreshtin për SXG-F, SXG-F-B 650 mg kompatibel me 4008 S dhe 5008 S. I njëjti katalog në web të prodhuesit nuk e ka këtë rresht as këtë dozë.  02/10/25

Pas një kerkimi të thjeshtë në web faqen e kompanisë me të cilën ka ofertuar kompania Meditech dhe e ka rekomanduar për dhënie të kontratës kunderligjeshëm AK -SHSKUK, në lot 1, gjenerohet katalogu zyrtar i prodhuesit në të cilin qartë vërehet ndryshimi në mes të katalogut të prezantuar në oferte nga OE Meditech, ashtu siç e ka pershkruar dhe raportuar anëtarja e komisionit vlerësues të ofertave në raportin e vlerësimit të ofertave ku argumentohet ndërhyrja fizike – falsifikimi i dokumentit zyrtar dhe krejt kjo me qëllim të përfitimit të kunderligjeshëm të kontratës e cila tani me i konsumon të gjitha elementet e vepres penale të sanksionuar me nenin 414 dhe 415, të KPRK-se.

- **Prove:** Linku i i prodhuesit ku konfirmon ndërhyrjen fizike – falsifikimin:

<https://sanxinmedtec.cn.made-in-china/Product-Catalogs/>

Se bashku me linkun në ju bashkangjesim edhe video deshmime se si mund të shkarkoni të njëjtin katalog të ketijë prodhuesi me të cilin është ofertuar me dokument të falsifikuar në lotin 1.


Për më tepër në si kompani për këtë qeshtë keni autorizuar edhe ekspertizë grafike nga ekspert të pavarur të certifikuar nga Keshilli Gjyqësor i Kosovës dhe ekspertimi teknik-grafik konstatoi se katalogu i paraqitur nga Meditech i prezantuar në oferte për tu kualifikuar si i përgjegjeshëm në lotin 1, në raport me katalogun origjinal të prodhuesit dhe të publikuar në ueb faqe kanë dallime të dukshme.

Është konstatuar se tek dokumenti i ofruar nga Meditech ekziston pjesë shtesë për:

- **SXG-F, SXG-F-B, 650g, 4008S, 5008S** që nuk figuron në dokumentin origjinal të prodhuesit.

Kjo pjesë shtesë, e cila i përmbush kërkesat e tenderit, është shtypur dhe printuar në kohë të dytë (post-factum) me ndryshim të fontit të shkronjave dhe shifrave, duke treguar për ndërhyrje/falsifikim në tabelën e specifikimeve të produktit sa i përket lotit 1.

Sipas ekspertit të certifikuar si i pavarur nga fusha e forenzikës, kjo pjesë shtesë është shtypur dhe printuar në kohë të dytë (pasuese – post -factum) me ndryshim të fontit të shkronjave dhe shifrave, duke argumentuar ndërhyrjen fizike dhe falsifikimin e dokumentit – tabelën e specifikimeve të produktit sa i përket lotit 1.



AK – SHSKUK – Komisioni vlerësues i ofertave, perkateisist zyrtari përgjegjës i prokurimit përveç obligimit ligjor të përcaktuar me nenin 99.2, të LPP-se dhe inicimit të procedurës për diskualifikim nga procedurat e prokurimit do duhej të ndermerreshiit veprime ligjore sipas nenit 130, par 1 dhe 3 të LPP-se ku kjarthe përcaktohet:

1. *Pa paragjykuar dhe sipas ligjit përkatës penal dhe ligjit tjetër në fuqi, konsiderohet shkelje e këtij ligji, e dëmshme dhe e zbatueshme në pajtim me ligjin në fuqi përkatës për çdo person:*
 - 1.1 *sigurojë, ofrojë, kërkojë, ose pranojë ose të tregojë gatishmëri për të siguruar, ofruar, kërkuar ose pranuar diç që është e vlefshme (duke përfshirë, por pa u kufizuar në, para, ofertë pune, pasuri materiale dhe jomateriale, favorizim ose shërbime) për përfitimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë ose pasurimin e punonjësit ose të ish punonjësit, zyrtarit ose ish zyrtarit të një autoriteti kontraktues, ose të një personi apo ndërmarrje që ka lidhje me ose që bashkëpunon me punonjësin, ish punonjësin, zyrtarin ose ish zyrtarin, në tërësi ose pjesërisht për të ndikuar ose tentuar për të ndikuar në vendimin ose masat që dëmtojnë, ose lidhen me inicimin, zbatimin ose rezultatet e aktivitetit të prokurimit ose shqyrtimit;*
 3. *Çdo nëpunës civil, punonjës ose zyrtar i autoritet kontraktues që vihet në dijeni, përmes çfarëdo mjeti, për veprën e përshkruar në paragrafin 1, të këtij neni ose për ndonjë rast që pritet të përfshijë një vepër të tillë, menjëherë duhet të njoftojë Ministrinë e Punëve të Brendshme.*

Pra për lot 1 OE i rekomanduar, Meditech, ka ofruar një ofertë thelbësisht të papërgjegjshme dhe potencialisht kriminale, të cilën AK-ja e ka injoruar:

Dëshmia për Falsifikim dhe Rreziku Shëndetësor për mbi 800 pacientet e Hemodializes është evident pasi qe:

- Falsifikimi Post-Factum është i konfirmuar dhe dyshimi është i bazuar me shume se mire, pasi qe ekziston ekspertiza Gjyqësore Tekninko-Grafike (Prova Nr. 10.1, datë 13.10.2025) e cila konstaton se katalogu i ofruar nga OE Meditech përmban ndërhyrje/falsifikim ku është shtuar rreshti për produktin SXG-F, SXG-F-B, 650g, kompatibil me aparatet 4008S. Kjo është bërë për të përshtatur të dhënat me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe për të lidhur kontrate kunderligjore.

- Përgjigja e prodhuesit e datës 03.10.2025, se ky ishte një "katalog i ndryshuar" (amended catalog) nuk e anulon veprimin e paraqitjes së një dokumenti të manipuluar në procesin e tenderimit me qëllim të përfitimit të kunderligjeshëm dhe përmes dokumentit të falsifikuar.
- Mungesa e CE Certifikatës: Kërkesa thelbësore është "CE Certifikata" për produktin e ofruar, dokument kyq i cili konfirmon cilësinë dhe kualitetin e produktit Komunikimi (Prove e bashkangjitur) me prodhuesin Sanxin konfirmon se ata nuk posedojnë CE Certifikatë për produktin 650g, por vetëm për produktin 700gr, duke bërë ofertën teknikisht të papërgjegjshme, pasi që nuk është kërkesë e dosjes së tenderit

Te gjitha këto prova dhe dëshmi tregojnë dhe duhet të jenë shqetësues pasi që rreziku i jetës së pacientëve të Hemodializes, pasi që mungesa e CE Certifikatës për produktin e saktë, përveç tentimit për mashtrim në prokurim, rrezikon seriozisht shëndetin e pacientëve në Hemodializë, jeta e të cilëve varet direkt nga kualiteti, cilësia dhe siguria e produktit.

Pretendimi ankimore 2:

AK – SHSKUK, si përgjigje ndaj kërkesës për ri shqyrtim në pretendimin ankimore nr. 2, si prove ka bashkangjitur emailin e datës 03.10.2025, ku në të njëjtin email potencohet kjo se Autorizimi i është dërguar personave fizik sic janë Agoni dhe Loriku – punetore të kompanisë Meditech, perkatesisht nuk i është dërguar subjektit juridik – Operatorit Ekonomik të rekomanduar: "Mecitech". Pra nga vet përmbajtja e kësaj shkrese elektronike le për tu kuptuar se edhe vet Autorizimi i prodhuesit është apo mund të jetë i manipuluar pasi që z. Robin Luo, nuk është i evidentuar si person i autorizuar apo përgjegjës i prodhuesit "Sanxin".

Prove: Emaili i datës 03.10.2025.

Ekrem Fetahu

From: Robin Luo-Sanxin Medtec <robin.luo@sanxin-med.com>
Sent: Friday, October 3, 2025 1:08 PM
To: Ekrem Fetahu
CC: sales
Subject: Resequant for clarification from SHSKUK

Follow Up Flag: Follow up
Flag Status: Flagged

Caution: This message was sent from outside your organization.

Print Sender | Block Sender

Dear Mr.Ekrem,

Thanks for sending the email for confirmation, we appreciate your effort.

Yes, we authorized Mr.Agoni and Mr.Lorik from company-Meditech sh.p.k. to attend the mentioned tender.

We sent certificates and Authorization letter and catalog, which we confirm is exactly the attached file you sent.

We have this product, and the amended catalog is officially sent by us, we would upload it on website soon.

Thanks again for your support again. P/s feel free to let me know anything else I can support. Have day.



Robin Luo
 Sales Manager
 Mobile: +86-170-8080272 | +86 1507000000
 Email: robin.luo@sanxin-med.com
 Company: Jiangxi Sanxin Medical Co., Ltd
 Site: www.sanxin-med.com
 Address: No.888 Fushan Road, Station Economic Development Zone Hangzhou City, Jiangxi Province
 P.R.China. 330000

Attention:
 For any changes of bank information, Sanxin should send an original copy of OFFICIAL STATEMENT with signature and stamp via DHL. And should send a scan copy by Email at the same time. Once any damage or loss raised by any other bank account change is not responsible for us.

Original:

Kjo përgjigje e me voneshme nga persona të pa autorizuar të prodhuesit, nuk e mohon aktin e paraqitjes së dokumentit të ndryshuar - manipuluar me fonde dhe shtesa, perkatesisht perveq katalogut si i manipuluar duket te jete edhe vet Autorizimi i "prodhuesit".

Dyshimet për manipulim me dokumentet e prodhuesit tregojnë edhe fakti se sqarimi për katalog nga AK është kërkuar tek personi jo përgjegjës: "robin.luo@sanxin-med.com" i cili nuk është i identifikuar në asnjërin nga dokumentet tjera të cilat OE i propozuar për dhënie të kontratës në lotin 1, i ka dorëzuar në ofertën e tij. Të gjitha këto tregojnë për anashkalim të përgjegjësisë ligjore të zyrtarit përgjegjës të prokurimit dhe me ngulm tentohet të lidhet kontratë me oferte me dokumente të falsifikuara.

Për më tepër në pozicionin 1, tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional edhe kërkuar:

"Autorizim nga prodhuesi për pjesëmarrje në këtë tender ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi (me të dhëna mbi prodhuesin, adresë, nr. tel, email, web faqja etj. për mundësi verifikimi). Në rast të autorizimit nga përfaqësuesi – dileri kërkohej edhe autorizimi i dilerit nga prodhuesi"

Operatori Ekonomik i propozuar për lotin 1, përkatësisht në autorizimin e prodhuesit "Sanxin", nuk figuron askund përshkrimi i emailit të cilit i është referuar AK – SHKSUK, për të sqaruar produktin dhe këto veprime tregojnë për manipulim, shkelje të parimeve bazike të prokurimit dhe potencialisht krim të organizuar më.

Në raportin e vlerësimit të ofertave tek rubrika e Vërejtjes përmbyllesë në lidhje me vlerësimin e tenderëve sipas qasjes së ofruar rezultoi që njëra nga anëtarët e komisionit vlerësues sa i përket lotit 1, ka potencuar se ka ndërhyrje fizike të kësaj dhe të dukshme dhe pavarësisht kësaj pjesë tjetër e komisionit ka proceduar tutje dhe me të njëjtin raport është proceduar tutje nga zyrtari përgjegjës i prokurimit i cili ka rekomanduar për dhënie të kontratës kompaninë e cila në oferte ka prezantuar dokument të falsifikuar.

Me kodin penal të Republikës së Kosovës nën 390 përcaktohet:

Neni 390 Falsifikimi i dokumenteve

1. Kushdo që përpilon dokument të falsifikuar, ndryshon dokumentin origjinal me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si origjinal ose me dije përdor dokumentin e falsifikuar apo të ndryshuar si origjinal, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër (4) vjet.

- **Prove:** Raporti i vlerësimit dhe raportimi i falsifikimit nga anëtarja e komisionit vlerësues të ofertave e gjeni të bashkangjitur në platformën e-prokurimi:

AK – SHKSUK, anëtarët e komisionit vlerësues të ofertave dhe zyrtari përgjegjës i prokurimit, me rekomandimin për dënimin e kontratës të ofertës së tillë kanë konsumuar edhe shkelje tjetër ligjore poashtu nga KPRK-se, përkatësisht nën 414 "Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar" dhe 415, "Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik", veprime këto të cilat ju dërgojnë në përgjegjësi penale dhe nëse kompani në rast të procedimit tutje me ofertën e tillë do të ndërmarrim veprime të menjëherëshme dhe lenden do ta deponojmë në Prokurorinë Perkatëse. Për veprime të tilla ju si AK, automatikisht do duhej ta eliminonit të njëjtën kompani si të pa përgjegjeshme në të gjitha llojet dhe në bazë të nën 99.2 të LPP-se të parashtroni kërkesë për diskualifikim dhe përjashtim nga procedurat e prokurimit publik. Shprehërimi i ofertës së tillë juve si AK – SHKSUK, gjegjësisht secilin zyrtarë përgjegjës ju bënë përgjegjës penalisht meqë ekziston dyshimi me

shumë se i bazuar mbi për abuzim me propozimin publik dhe parime publike, përfshinë edhe shkaktojnë rrezikun të përgjithshëm.

Pra AK - SHSKUK, ka marrë dhe ka përdorur kontraktin e tij emaili të pa konfirmuar si kontakt primar, pa e përfshirë atë në dokumentin burimor - Autorizimin e prodhuesit dhe kjo tregon për marrëveshje eventuale paraprake të një grupi të caktuar.

Pretendimi ankimore 3:

Tek kërkesa e dosjes së tenderit përkateisht tek aftësia teknike dhe profesionale (Kërkesa 3) në Dosjen e Tenderit është kërkuar: "CE Certifikata" për produktin e ofruar.

CE Certifikata e lëshuar nga "TÖV Rheinland" dhe e ngarkuar në ofertën e OE të propozuar për dhënie në lotin 1, mbulon kategorinë e gjerë "Hemodialysis Powders". Kjo certifikatë dëshmon sistemin e cilësisë, por nuk përmend në mënyrë të qartë dhe specifike përmasën 650g/400SS & 500SS për pluhur B si një produkt të certifikuar.

Për më tepër certifikata CE Certifikate e paraqitur në ofertë të OE Meditech për lotin 1, nuk ofron kurrëfarë të dhënash lidhur me produktin e ofruar.

Për të konfirmuar këtë fakt nëse OE kemi prezantuar komunikimin zyrtarë nga partneret tane të cilët janë pjesë e kësaj procedure të prokurimit me prodhuesin me të cilin ka ofruar OE Meditech në lotin 1, dhe se nga komunikimi me "Sanxin", konfirmohet që nuk posedon fare CE Certifikatë për produktin e ofruar në lotin 1. Koncentrat p uhur i bikarbonatëve qesh 650 gr, por deklaron që ka CE Certifikatë vetëm për produktin 700gr i cili gjendet në katalogun zyrtarë të tyre, që nënkupton se OE i propozuar përveq se ka rrethhyrë në katalog duke shtuar të dhëna të pa qena për produktin dhe për ta përshatuar me kërkesat specifike të FDI-së, ka paraqitur edhe CE Certifikatë që nuk i përket fare produktit me të cilin ka ofruar, pasi që ky produkt nuk ka fare CE Certifikatë.

Kjo përpos që është tentativë për mashtrim në prokurim publik, rrezikon seriozisht shëndetin e pacientëve të varur në baza ditore me Hemodialize të cilët janë kategori e veçantë vërejtja e këtyre pacientëve varet direkt nga kualiteti, cilësia dhe siguria e produktit, të cilët i garanton CE Certifikata dhe se kjo paraqet rrezik serioz dhe të përgjithshëm në këtë kategori pacientësh.

Pra OE i propozuar për dhënie të kontratës në lotin 1 në ofertë ka prezantuar dëshmi të shantazistike mashtruese dhe të falsifikueshme ku AK - SHSKUK, nuk ka ndërmarrë kurrëfarë veprimesh ligjore për ta eliminuar të njëjten ofertë, përkundrazi me çdo kusht tentohet të lidhet kontratë me të njëjten kompani ani pse të gjitha provat tregojnë për krim të organizuar përmes procedurave të prokurimit.

- Provat Komunikimi dhe konfirmimi i prodhuesit "Sanxin" me të cilin ka ofruar OE i propozuar ku dëshmohet kurrë mungesa e CE Certifikates, për produktin e ofruar në lotin 1

From: phoebe.peng@jswin-med.com <phoebe.peng@jswin-med.com>

Sent: Saturday, October 11, 2025 10:56 am

To: [REDACTED] <[REDACTED]>

Subject: Re: Kind request

You don't often get email from phoebe.peng@jswin-med.com. [Learn why this is important](#)

CAUTION: This is an EXTERNAL email. DO NOT click links or open attachments unless you recognize the sender and know the content is safe.

Dear [REDACTED],

How are you? Nice to hear the inquiry from you.

Please find the attached catalogue for the dialysis powder and quotation.

You will note there are two types of bbac Fresenius 4000 and 5000 respectively. And bbac from Fresenius is 650g, but what we documented in MDD CE certificate is 700g. If you require the product with CE certificate, we can provide only 700g instead of 650g. While if you can import without CE certificate, we can provide 650g.

If you have any further questions, please let us know freely.

Thanks



Phoebe Peng

Regional Director / Overseas Business Director

Tel: +86 475-0300203 | +86 13770002156

Email: phoebe.peng@jswin-med.com

Company: Jiangsu Swin Medical Co., Ltd.

Website: www.jswin-med.com

Address: 10-302 Fushan Road, Xuzhou Economic Development Zone Xuzhou City, Jiangsu Province P.R.China 221000

Attention:

For any changes of bank information, "Swin" should send an original copy of OFFICIAL STATEMENT with a signature and stamp via DHL. And should send a scan copy by email at the same time. If any change or loss issued by any other bank, Swin account change is not responsible. "Swin"

Komisioni vlerësohet i ofertave dhe zyrtari përgjegjës i prokurimit për këtë procedurë të prokurimit kanë të nënshkruara deklaratat nën betim dhe kanë marrë përgjegjësi civile edhe penale për vlerësim korrekt të ofertave, madje sipas paragrafit 1 të nenit 59 të LPP-së, përgjegjësia është vetëm individuale dhe secili anëtarë do të jetë përgjegjës vec e vec për vlerësim të tillë subjektiv dhe jo objektiv.

Pretënimi ankimore 4:

Favorizimi i hapur ndaj kompanisë Meditech konfirmohet edhe në lotet 3 dhe 6, ku AK – SHSKUK, pavarësisht kërkesave kualifikuese të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe katalogut të prezantuar në oferte ndaj lotit 6 në aneksin 1 -specifikacionet teknike të detyrueshme është kërkuar:

Linja A-V

Kompatibile me aparatoren – diametri i dhomëzës venoze 18-22mm – Segmenti i pompës me diametër 8mm dhe gjatësi mbi 32 cm.

Operatori Ekonomik "Meditech", është propozuar për dhënie të kontratës në lotin 6 ani pse në katalogun e tij nuk ka prezantuar asnjë dëshmi përmes të cilit konfirmohet se diametri i dhomëzës venoze ka vlerën 18-22mm apo segmentin e pompës 8mm dhe gjatësinë mbi 32 cm. Pavarësisht këtij fakti e nejtë oferte propozohet për dhënie madje me ngulm.

- **Prove:** Katalogu i prodhuesit me të cilin ka ofertuar OE i propozuar në lot 6 ku konfirmohet se nuk ka të prezantuar asnjërin nga parametrat e kërkuar:

TECHNICAL PARAMETER

Applicable Machine	Sterilization Method
Fresenius 2008F 4008	E-GAMMA Beam
GAMBRO A920/9450/300/300/300 1A 10A	E-GAMMA Beam
B. BRAUN OMALOG/DALOG	E-GAMMA Beam
DELCO FORMULA 2000	E-GAMMA Beam
KOSPAL INTEGRAL/REGAL/PLA	E-GAMMA Beam
AKKISO ZEB-B1/051/06/07/11	E-GAMMA Beam
APPO-NEO-INSURONAL 18FLUS	E-GAMMA Beam
TOPAY 301-061/18-0003/12/13	E-GAMMA Beam
ASAH VDS-101	E-GAMMA Beam
DSR-8000	E-GAMMA Beam



Suitable for most models of the blood purification equipment: FRESenius, B. BRAUN, BAXTER, etc.



Medical grade PVC material



Efficient & convenient



Various sterilization methods: EO, GAMMA, E-BEAM

Me nenin 28 dhe nenin 59 te LPP-se, percaktohet qarte qe oferta duhet te deshmohet me dokumentacion dhe jo vetem me moster, si rrjedhoje mungesa e specifikacionit ne katalog automatikisht duhet ta eliminoni ofertën si te pa pergjegjeshme. Kjo konfirmohet edhe me nenin 10, te UOPP-se, nr. 001/2023.

Pretednimit ankimore 5:

Meqene se nuk na është ofruar qasje ne si OE supozojme dhe dyshojme se oferta e OE-ve Medicom, Trimi Med dhe Medi Lor, Argomed, AGS dhe Brupharm, janë te pa pergjegjeshme ne lotin 1, 3 dhe 6, për faktin se ne piken e aneksit 1, te dosjes se tenderit përkatësisht – specifikacione teknike te detyrueshme për këtë lot është kerkuar:

“Koncentrat Pluhur i Bikarbonateve” ne qese 650 gr , kompatibil me aparatoren ekzistuese 4008S

AK – ka bere te pa mundur krijimin dhe argumentimin e pretendimeve ankimore ku me mos ofrim te qasjes ne oferta te këtyre kompanive ka konsumuar shkelje nga neni 10 dhe 12, ku detyrim i secilit AK, perkates është ofrimi i “verzionit te spastruar” sipas nenit 11, par 4 te LPP-se, për secilin dookument dhe me këtë AK – SHSKUK, ka mohuar ofrimin e qasjes.

Pavaresisht kesaje AK e ka bere te pa mundur te ofertohej me koncentrat pluhur te bikarbonateve, pasi qe qeset 650 gr kompatibil për pajisjen 4008S janë te pashfrytezueshme për arsye se konektoret e këtyre aparateve janë nderruar me konektore te aparatures 5008S dhe si te tilla e bëjnë produktet ne qese prej 650 gr kompatibil me pajisjen 4008S te pa perdorshme dhe pse janë brenda specifikave teknike te kerkuara, ndërsa qeset 650 gr kompatibil me 5008S te cilat nuk janë brenda specifikave teknike te kerkuara ne dosjen e tenderit si rrjedhoje ofertat e tilla duhet te eliminohen ne tërësi si te pa pergjegjeshme, pasi qe sipas informacioneve nga Qendrat e Hemodialzies, pajisjet egzistuese jane te modelit

4008S, kurse konektoret per kete produkt jane per pajisje qe nuk ekzistojne te modelit 5008S, konektor te cilet i ka nderuar pikerisht kompania tani e rekomanduar per dhenien e kontrates "Meditech". Per kete qeshtje AK – SHSKUK, perkatesisht zyrtari pergjegjes i prokurimit, ne vendmin ndaj kerkeses per ri shqyrtim, akuzon kompanin tone duke deformuar gjendjen faktike dhe manipulimin me procedura te prokurimit tenton ta zhvendos dhe akuzon ba baze ligjore, ku per kete qeshtje ne si kompani do te ndermarrim veprime ligjore.

Pretendimi ankimore 6:

Autoriteti Kontraktues – SHSKUK, nuk ka realizuar kurefare vleresimi real dhe ne mēnyrē te hapur ka favorizuar kompne per qellim te perfitimit te kunderligjeshem ndaj vetes apo kompanise perkatese, perkatesisht me nenin 3, te Rregullave per tenderet jo-normalisht te ulet (legjislacion sekondare i publikuar nga KRPP dhe ne fuqi) percaktohet:

3.1 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;*
- ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;*
- iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.*

Ne lot 1 – është rekomanduar: Meditech me çmim te pergjitheshem prej 363,617.76 € dhe ju si AK nuk i keni ndërmarrë veprimet ligjore sipas nenit 61 te LPP-se, lidhur me nenin 4.2 te kesaje rregulloreje.

$(363,617.76 \text{ €} + \dots + 719,457.60 \text{ €}) \text{ Pragu } 30\% (30\% \text{ i çmimit mesatar}) = 534,800.74 \text{ €}$
 $534,800.74 \text{ €} \times 70\% = 374,360.52 \text{ €}$

$449,174.88 \text{ €} \times 90\% \text{ Pragu } 10\% (10\% \text{ i çmimit të dytë}) = 404,257.39$

Çmimi i rekomanduar për dhenien e kontratës prej 363,617.76 € nga Meditech.

Nuk e kalon as prapun e dyre prej 30% dhe as atë te e trete prej 10% perkateishti vlerën prej: 404,257.39 €, te gjitha ofertat me çmim nen këtë vlere do duhej te eliminoheshin si oferta me çmim jo normalisht te ulet, perkatesisht oferta e Meditech, i plotëson të tri kushtet ligjore dhe juve si AK eshte dashur të ndërmarni procedurën inter partes.

Për këtë qeshtje juve si OSHP, ne web faqen e sajë keni te publikuara me dhjetra vendmie ku kompanite me oferta te tilla janë eliminuar siç është vendmimi me nr. OSHP: 2023/0892, i datës 19/01/2024, vendimi me nr. OSHP: 2024/0762, idates 21/10/2024 dhe shum vendime tjera te cilat i gjeni ne : <https://oshp.rks-gov.net>.

Ngjashem qendron fakti edhe tek loti 3, ku operatori ekonomik i rekomanduar per dhenin e kontrates ne lotin 3, ka ofertuar me cmim jo normalisht te ulet, ku AK – SHSKUK, nuk ka ndermarr kurrefare veprimi ligjore per te kalkuluar dhe gjykuar qeshtjen e cmimit jo normalisht te ulet.

Pretendmi ankimore 7:

Pas publikimit te vendmit mbi rezultatine e aktiviteitit te prokurimit kompania jone ka kerkuar qasje ne dokumentacionin e Operatirit Ekonomik, te propozuar për dhenien e kontrates dhe kompanive tjera pjesemarrese ne këtë procedure te prokurimit te cilat janë kualifikuar si te pergjegjeshme por te pa sukseseshme ku AK – SHSKUK, ka mohuar qasjen dhe ka shkelur dispozitat ligjore nga neni 10 dhe 11 i LPP-se.

Përgjatë qasjes në dokumentacionin e tyre si OE, nuk na është lejuar as shikimi në shkresë të ofertave të operatorit ekonomik të rekomanduar si në vlerësim fillestar po ashtu edhe pas të vlerësimit të ofertave dhe as me pak kopjimi dhe marrja e shkresave, me arsyetimin se të njëjtat oferta si tërësi janë deklaruar sekret afarist.

Mos ofrimi i qasjes në dokumentacion publik është shkelje esenciale e ligjit për prokurim publik, nr 04/1-04/2, i nënshkruar dhe plotësuar me ligje tjere. Përgjatë qasjes në dokumentacion na është lejuar qasje vetëm në deklarate nën hetim, formular të tenderit, Liste të çmimeve - paratase dhe paralogari, kërkesa për konfidencialitet !

Neni 10 dhe 11 i LPP-se, përmbledhësisht nën 7, i rregullares për prokurim publik, qartë tregojnë qashtjen e dokumentacionit sekret afarist

Neni 7, i Rregullores me nr. 001/2022, paragrafi 6 dhe 7 përcaktojnë:

Informacionet mund të klasifikohen si konfidenciale vetëm nëse:

a. Operatori Ekonomik për veç se i identifikon ('marken') dokumentet si "sekret afarist" gjatë ngratimit të tyre në Sistemin Elektronik të Prokurimit Publik, i njëjti duhet të plotësojë Aneksin 3 të Dosjes së Tenderit " Kërkesa për sekret afarist".

b. Nëse Operatori Ekonomik konsideron që informatat e dorëzuara sipas nenit 68 dhe 69 të LPP-se të trajtohen nga Autoriteti Kontraktues si informata sekrete afariste në përputhje me nenin 11 të LPP-se, i njëjti duhet të shkarkojë nga sistemi Aneksin 3 "Kërkesa për sekret afarist", të plotësojë duke dhënë arsyetimet për secilin dokument të identifikuar si "sekret afarist", nënshkruaj dhe vulos aneksin, si dhe ta ngarkojë në sistem së bashku me dokumentet tjera të tenderit të tij. Është përgjegjësi e AK-së për të siguruar që pjesët të cilat janë deklaruar si sekret afarist nuk janë vendë në dispozicion Operatorëve të tjerë ekonomik.

Dispozita të nenit, 11, i LPP-se, paragrafi 3, pika 3.3 dhe 4, përcaktojnë që: "OE, i cili deklaron ofertën konfidenciale duhet të argumentoj përmes deklaratës me shkrim, ku domosdo duhet të vërtetohet se ndonjëri nga elementet e tenderit nuk është prone publike dhe të dhënat mbrohen dhe në detaje do të arsyetohet konfidencialiteti apo sekreti ku zbulimi i tyre do të rezultonte në dëmtim material apo komercial të operatorit ekonomik "

Ndërsa paragrafi 4 i nenit 11, të LPP-se përcaktor se, "Autoriteti kontraktues që e ka klasifikuar një element të informates si informate sekrete afariste sipas paragrafit 3, të këtij neni, do të përgatit versionin e "pastruar" të çdo dokument...

Ligjërisht sekret afarist mund të konsiderohen vetëm të dhënat personale, zyra e Prokurimit, në kuptim të paragrafit 4 të nenit 11, të LPP-se, është dashur ta përgatise versionin e pastruar të dokumenteve ndaj OE të rekomanduar për dhënie të kontratës, rrjedhimisht me mos ofrim të qasjes, ja si AK, kemi shkëlur edhe dispozitat e nenit 10 të LPP-se - anjetet për promovimin e transparencës.

Neni 97 i Rregullores për prokurim publik nr. 001/2022, pika (3), mos ofrimin e qasjes e klasifikim si shkelje të rrede të ligjit për prokurim publik.

c) Mos lejuar dherose neplizhjen i qasjes në dokumenteve zortore sipas kërkesës me shkrim të parashruar nga pala e interesit kur një qasje e tillë e kërkuor është në përputhje me nenin 10 dhe 11 të Ligjit të Prokurimit Publik,

Qasja e plotë në dokumente publike është e garantuar edhe me nënparagrafin 3.2, të nenit 17 të ligjit nr. 06/L081, për Qasje në Dokumente Publike, si dhe me nenin 12, 13 dhe 14, të ligjit nr. 06/L-082, për Mbrojtjen e të dhënave personale.

- OSHP, ka nxjerre dhjetra vendime ku mohimi i qasjes në dokumente publike është gjykuar ndryshe nga ju si AK madje edhe është sanksionuar.
- Si analigji dhe konsistence mund të referoheni vendimit me nr. 606/23 ; 877/23 e shumë vendime tjera publike në ueb faqen e OSHP-se: <https://oshp.rks-gov.net>.

Për mos ofrim të qasjes në dokumente publike edhe Agjencia për Informim dhe Privatesi ka të nxjerra me dhjetra vendime për mos ofrim të qasjes madje edhe ndeshkime: (shiqo vendimin me nr. 770/2024; vendimi nr. 875/2024 – www.aip.rks-gov.net).

Si perfundim:

Marrë parasysh natyrën komplekse të pretendimeve tona, të cilat përfshijnë dyshime të forta për falsifikim të katalogut dhe dokumenteve tjera të bashkangjitura në oferte dhe rrezikun potencial për sigurinë e pacientëve që janë të varur me hemodializë, për shkak të mos-përputhjes së produktit me kërkesat e CE Certifikatës, në si kompani kërkojmë që OSHP dhe zyrtaret përgjegjës, bazuar në nenin 113 dhe nenin 114, të LPP-së, kërkojmë që të autorizohet ekspert/e i/e pavarur, të paanshëm dhe objektiv për të shqyrtuar dhe vlerësuar në plotëni të fakteve dhe provave të kontestuara dhe të argumentuara.

Kjo kërkesë, bëhet me qëllim që të evitohet çdo dyshim mbi shqyrtimin subjektiv të AK-së – SHSKUK, dhe që të vërtetohen përfundimisht shkeljet e mësipërme në atë mënyrë që paneli shqyrtues të nxjerri këtë:

V E N D I M

- I. Të aprovohet**, në tërësi si e bazuar ankesa e OE Medhealth LLC - Prishtine
- II. Të anulohet**, njoftimin mbi vendimin e AK-së të datës 08.10.2025, si i kunderligjeshëm dhe të kthehen Lotet **1, 3, dhe 6** në Rivleresim
- III. Të njoftohet**, KRPP me shkeljet ligjore të zyrtarit përgjegjës të prokurimit dhe të inicohet procedure për revokimin e certifikates të zyrtarit përgjegjës siç percaktohet **me nenin 25.8 të LPP-se**.
- IV. Të diskualifikohet**, OE Meditech nga të gjitha lotet si të papërgjegjshëm dhe të ndermirren veprime ligjore sipas nenit 99.2, të LPP-se, përjashtimi nga procedurat e prokurimit për periudhjen deri në një (1) vit;
- V. Të njoftohet**, MPB me falsifikimin e ofertes ashtu siç percaktohet me nenin 130, par 3, të LPP-se dhe të inicohet procedure hetimore ndaj OE Meditech dhe
- VI. Të lejohet**, kthimi i mjeteve të deponuara në emër të ankesës.

Në të kundërtën operatori ekonomik ankues, për këtë procedurë të prokurimit tani me vetëm ka ndërmarrë veprime ligjore në atë mënyrë që përgjegjësist për shkelje ligjore abuzim dhe mos prezantim të falsifikimit perkateissht tentativen për lidhje të kontratës përmes dokumenteve të falsifikuara në organet kompetente dhe se çdo shkelje ligjore në procedurën e shqyrtimit të ankesës në OSHP perseri do të raportohet

Se bashku me ankesë bashkangjitur gjëni provat:

- Raportin e ekspertizës forenzike grafike
- Kërkesën për ri shqyrtim
- Vendimin e AK-së refuzimin e kërkesës
- Komunikimet elektronike me prodhuesit
- Katalogun e dorëzuar në ofertë
- Katalogun e publikuar në ueb faqen e prodhuesit etj.

9. Dëmet materiale

Përshkrimi mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkakton ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshihet pretendimi për kompensim.

Dëmet materiale janë të konsiderueshme dhe të njëjtat kërkojnë që të kalkulohen dhe të kompensohen ashtu siç përcaktohet në LPP.

10. Lista e dokumenteve (dëshmi) të bashkëngjitura

Nëse aplikohet bashkëngjitur ankësës dokumentet e venditorit më poshtë

- një kopje të publikimit të "Njoftimit për Konkurs" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit".*
- një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- një kopje të letres së caktimit të tenderuesit/kandidatit/ letres së tenderuesit të pasuksesshëm/ letres për mos përkualifikim.*
- një kopje të procesverbalit të kopjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*
- bashkëngjiti një kopje të vendimit të marrë nga AK gjatë kontekstut paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së.*
- Dëshmitë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-së, dhe*
- të gjitha korrrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informata të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi si dhe me secilin pretendim të paraprirur në ankese*

¹¹ Sipas Nenit 111.2 të LPP Parashtruesi i ankesës rangjohet si ankesës do t'ia dorëzojë USHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.